

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

UJESJELLES-KANALIZIME SH.A- SARANDE

Sarande, me 18.07.2018

Për : “ARTI”, SHPK

NIPT J64103808P

Procedura e prokurimit : Kerkese per propozim

Numri i references se procedures : **REF-75777-06-20-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: : **“NDERTIM STACIONI POMPIMIT TEK LAGJA ”
BABA REXHEPI”**

Fondi limit : 4.140.323 (katërmilion njëqind dyzet mijë e treqind e njëzet e tre) leke pa tvsh

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Publikime të mëparshme : **Buletini i Njoftimeve Publike nr. 25, date 25 Qershor 2018**

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

"ARTI" shpk

NIPT J64103808P

3,933,044 leke pa tvsh

“B-93” shpk

NIPT J62903508R

3,566,172 leke pa tvsh

Jane s.kualifikuar ofertuesit e meposhtem:

“B-93” shpk

Perkatesisht per arsyet e meposhtme :

Ne baze te nenit 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”, dhe nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm

nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlersimit të Ofertave në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “B-93”, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme, nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, pasi kontrata në fjalë nuk ka të përfshirë disa kapituj punimesh të cilat kanë zërat dhe elementët e tyre, duke mos vërtetuar se gëzon eksperiencë në kryerjen e punimeve si **“Punime Elektike”**, pra në asnjë rast nga ana e operatorit ekonomik nuk është vërtetuar kryerja e punimeve të tilla të ngjashme.

Në oferten e tij ekonomike **“ Punimet Elektrike”** zene mbi 57 % të punëve që operatori ekonomik kërkon të realizojë, por sipas situacionit të kontratës të paraqitur për punët e ngjashme nga operatori ekonomik “B - 93” sh.p.k. për këtë procedurë prokurimi rezulton se në kontratën e ngjashme të paraqitur, të mos jenë kryer zëra të tillë punimesh, qoftë edhe në një vlerë minimale për të vërtetuar se ky operator ekonomik është i aftë dhe ka kapacitetet e duhura për të kryer punimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Komisioni i Vlersimit të Ofertave konstaton se elementët e kërkuar në preventivin e përcaktuar në dokumentat e tenderit nuk gjejnë pasqyrim në situacioni përkatës të kontratave të dorëzuar nga operatori ekonomik për vërtetimin e eksperiencës së mëparshme.

Sa më sipër, Komisioni i vlersimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk ka vërtetuar se gëzon eksperiencë të mëparshme në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Në rastin konkret, Komisioni i Vlersimit të Ofertave vlerëson se kontrata e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe nuk mund të konsiderohet e vlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Shoqerine: **“ARTI” SHPK, NIPT J64103808P Adresa : Lagjia nr. 1, Rruga “Onhezmi” Sarandë, se oferta e paraqitur, me vlerë : 3,933,044 leke pa tvsh (tremilion nentëqind tridhjetë e tremijë zero dyzet e kater) leke pa tvsh**

është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Ujesjelles Kanalizime sh.a Sarandë* kopjen e sigurimit të kontratës, si dhe të paraqiteni për nënshkrimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë më datë **04.07.2018**

Ankesa : Nuk ka patur

